

VENDIM
Nr. 140, datë 20.3.2019

**PËR MIRATIMIN E PARAQITJES, TË FORMËS DHE TË SHENJAVE DALLUESE
TË UNIFORMËS, NË NJËSI TË VEÇANTA TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË
SHTETIT**

(ndryshuar me vendimin nr.308, datë 16.4.2020)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 33, të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005, “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e paraqitjes, të formës dhe të shenjave dalluese të uniformave për njësi të veçanta të Shërbimit Informativ të Shtetit (njësisë përgjegjëse për sigurimin fizik të objekteve dhe informacionit të klasifikuar), që përdoren vetëm gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Shenjat dalluese të Shërbimit Informativ të Shtetit janë logoja, numri i identifikimit dhe shiriti me fjalën “SIGURIA”, në uniformë. Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të shenjave dalluese të shërbimit, që do të vendosen në uniformë, janë të përcaktuara në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Llojet e uniformës, që do të ketë në përdorim kjo njësi, janë:

- a) uniforma dimërore;
- b) uniforma verore.

4. Paraqitja dhe forma e uniformës së shërbimit janë të përcaktuara në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit *miraton normën e furnizimit me shenja dalluese dhe mënyrën e përdorimit të tyre, për të vijuar me procedurën e blerjes.*

6. Shenjat dalluese të Shërbimit Informativ të Shtetit, të miratuara sipas këtij vendimi, për nga qëllimi i përdorimit, janë pronë e Shërbimit Informativ të Shtetit dhe përdoren vetëm gjatë ushtrimit të detyrës.

6/1. Punonjësit e strukturës përgjegjëse për sigurinë fizike të objekteve dhe informacionit të klasifikuar të trajtohen sipas statusit të punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

7. Shenjat dalluese të Shërbimit Informativ të Shtetit janë të patjetërsueshme. Ndalohet shumëfishimi dhe realizimi i modeleve e i ngjyrave të tyre, për përdorues të institucioneve apo të subjekteve të tjera.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për programin buxhetor të Shërbimit Informativ të Shtetit.

9. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Erion Braçe

ANEKSI 2

UNIFORMA

INDEKSI

I. UNIFORMA DIMËRORE

1. Xhup me veshje të ngrohtë, blu i errët
2. Kostum i zi, material i trashë
3. Këmishë me mëngë të gjata, ngjyrë bezhë e çelur
4. Kravatë me ngjyrat e logos zyrtare të SHISH-it
5. Këpucë me qafa dimërore, të zeza
6. Pulovër e trikotuar jakë “V”, blu e errët
7. Kapelë tip sportive, blu e errët, me logo

II. UNIFORMA VERORE

1. Kostum i zi, material i hollë
2. Këmishë me mëngë të shkurtra, ngjyrë bezhë e çelur
3. Këpucë gjysmëverore, të zeza
4. Kravatë me ngjyrat e logos zyrtare të SHISH-it

I. UNIFORMA DIMËRORE

1. Xhup me veshje të ngrohtë, blu i errët



2. Kostum i zi, material i trashë



3. Këmishë me mëngë të gjata,
ngjyrë bezhë e çelur



4. Kravatë me ngjyrat e logos zyrtare
të SHISH



5. Këpucë me qafa dimërore, të zeza



6. Pulovër e trikotuar jakë "V", blu e errët



7. Kapelë tip sportive, blu e errët, me logo



II. UNIFORMA VERORE

1. Kostum i zi, material i hollë



2. Këmishë me mëngë të shkurtra, ngjyrë bezhë e çelur



3. Këpucë gjysma verore, të zeza



4. Kravatë me ngjyrat e logos zyrtare të SHISH



ANEKSI 1 SHENJAT

1. Logoja e Shërbimit Informativ të Shtetit
2. Shirit me numër identifikues
3. Shirit me fjalën “SIGURIA”

1. Logoja e Shërbimit Informativ të Shtetit

Logo me qëndisje me relief, e heqshme nga uniforma për këmbishën me diametër 8 cm.
Logo e qëndisur në kapele me diametër 5 cm.



2. Numri identifikues

Numri identifikues i shkruar në shirit me ngjyrë blu si të logos zyrtare, i qëndisur me relief me përmasa 8 cm x 3 cm, i heqshëm për t'u vendosur në këmbishë.

1 0 5 6

3. Shirit me fjalën "SIGURIA"

Fjala "SIGURIA" e shkruar në shirit me ngjyrë blu si të logos zyrtare, e qëndisur me relief me përmasa 8 cm x 3 cm, e heqshme për t'u vendosur në xhup.

SIGURIA